

## KONTRATË SHITJE

Sot më datë 05/11/2021 palët pjesmarrëse kanë rënë dakort për lidhjen e kontratës së mëposhtme”

### **PALËT PJESMARRËSE NË KONTRATË :**

**Arben Kozma Vrushi** i datelindjes 28/09/1966 , shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi **G60928006U**, lindur më Elbasan, Shqipëri me adresë banimi Elbasan, Shqipëri. (Shitësi)

**Lindita Muharrem Vrushi** e datelindjes 13/05/1969 , shtetase shqiptare, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi **G95513012N**, lindur më Elbasan, Shqipëri me adresë banimi Elbasan, Shqipëri (Blerësi)

### **Neni 1**

#### **OBJEKTI I KONTRATËS**

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave zotëruese nga Z.Arben Vrushi i cili përfaqëson 50.5 % të kapitalit të shoqërisë “**Nenna Manufactory**” me numër unik (**NUIS**) M13002201D, me adresë :Labinot fushe MENGEL Rruga Nacionale ElbasanLibrazhd km 2,, Elbasan ( ndertesa ka 2 kate, kati nentoke 397,1 m2+ kati perdhe 384,4m2.

- Shitjen e kuotës zotëruese nga Z.Arben Vrushi **50.5 %** të kapitalit të shoqërisë, “**Nenna Manufactory**”.

### **Neni 2**

#### **Cmimi**

Cmimi i shitjes së 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50.5% të kapitali të shoqërisë “**Nenna Manufactory**” është 50 500 lek .

**Neni 3**  
**Afati i pagimit te cmimit**

Pagimi i cmimit do të kryhet pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

**Neni 4**  
**Të drejtat dhe detyrimet e shitesit**

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë nga blerësi pagimin e cmimit ne mënyrën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë.
2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzoje blerësit të gjithë dokumentacionit që shënon të drejtën e pronësisë dhe që janë të nevojshme për kalimin e saj.
3. Shitësi duhet te garantoje bleresin per gezimin e qetë te kuotave nga cdo e drejtë pronësie të personave të trete. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nese ai thirret prej tij, për ta garantuar ndaj pretendimeve te personave te trete, mbi kuotat objekt i kontrates.

**Neni 5**  
**Te drejtat dhe detyrat e bleresit**

1. Bleresi ka të drejtë te kërkojë dokumentat qe vërtetojnë pronësinë e shitësit mbi kuotat, objekt kontrate nga shitesi nga e nesermja e hyrjes ne fuqi të kësaj kontrate.
2. Bleresi eshte i detyruar të marrë në zotërim vendin ku shoqëria ka qendrën e ushtrimit të aktivitetit

**Neni 6**  
**Zgjidhja e kontratës**

1. Shitesi ka të drejtë të kërkojë të zgjidhe kontraten kur:



- a) blerësi nuk paguan cmimin.
- b) blerësi nuk merr në dorëzim objektin ku shoqëria ushtron aktivitetin , brenda 15 ditëve nga afati shtesë i caktuar nga shitësi;
- c) blerësi nuk merr në dorëzim dokumentat e pronësisë së kuotave

2. Bleresi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur:

- a) shitësi nuk dorëzon dokumentat e pronësisë së kuotave
- b) shitësi nuk dorëzon objektin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, objekt kontrate brenda afatit shtesë 10 ditor, te caktuar nga blerësi ;
- b) shitësi deklaron brenda afatit 10 ditor se nuk do te dorezojë dokumentacioni dhe objektin e ushtrimit të aktivitetit;

### **Neni 7**

#### **Pasojat e zgjidhjes se kontrates**

1. Shitësi me zgjidhjen e kontratës duhet t'i kthejë pagesat e bëra blerësit, dhe gëzon të drejtën për shpërblimin e dëmit .

### **Neni 8**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Në rast mosmarrveshje midis tyre palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim, dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur ato do t'i drejtohen gjykates se "Rrethit Gjyqësor Elbasan".

### **Neni 9**

#### **Shpenzimet per lidhjen e kontratës**

Shpenzimet për lidhjen e kësaj kontrate i ngarkohen te dyja palëve përkatësisht.



## Neni 10

### Momenti i kalimit të pronësisë dhe Hyrja në fuqi

Kuotat zotëruese të ortakut **Arben Vrushi** në shoqërinë “**Nenna Manufactory**” Shpk në datën 05/11/2021 kalojnë në pronësi të **Znj.Lindita Vrushi** si më poshtë:

- Kuota zotëruese nga **Z.Arben Vrushi** I cili përfaqëson 50.5% të kapitalit të shoqërisë I kalojn **Znj.Lindita Vrushi**

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën 05.11.2021

## Neni 11


### Hartimi i kontratës

Kjo kontratë u hartua në **2 (dy)** kopje nga një për secilën palë.

### PALËT KONTRAKTUESE

**SHITËSIT :**

**Arben Vrushi**



**BLERESI**

**Lindita Vrushi**

